



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.22
Prishtinë, më 23.5.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Adem Mikullovc, Verica Çeraniq dhe Mufera Shinik.

Munguan: Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku–Rexhepi, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të mediave

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 maj 2018;**
- 3. Shqyrtim i projektligjit nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 maj 2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15 maj 2018 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtim i projektligjit nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë

Ismajl Kurteshi, në fillim të mbledhjes, shprehu shqetësimin dhe kritikën e tij mbi mungesën e përfaqësuesve të ministrisë në mbledhje. Ai tha se MASHT-i ka filluar të pengojë punën e komisionit, pasi që projektligji për Inspektoratin e arsimit është vonuar për shkak të neglizhencës nga ana e ministrisë për përcaktimin e sanksioneve kundërvajtëse me gjobë, ndërsa në mbledhjen e sotme, ku në rend dite është shqyrtimi i Projektligjit për Inovacion mungon përfaqësuesi i ministrisë edhe pse ishte i njoftuar për këtë takim. Kryetari propozoi që komisionit t'i drejtohet MASHT-it me shkresë përmes së cilës shpreh shqetësimin për mos pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrisë gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

Nezir Çoçaj u pajtua me këtë propozim për dërgimin e shkresës në MASHT. Ai gjithashtu shtoi që përpos drejtorëve të departamenteve në ministri, edhe prania e ministrit do të ishte e vlefshme për shqyrtimin e këtij projektligji. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka ky projektligj, ai tha se do të ishte mirë që në këtë takim të ishin të pranishëm të gjitha palët me interes që merren me inovacion shkencor. Gjithashtu, ai shtoi se, pa u konsultuar me të gjitha palët e përfshira, komisioni nuk mund të përmbyll shqyrtimin e këtij projektligji.

Teuta Haxhiu tha se duhet mbajtur një dëgjim publik, ku të pranishëm të jenë të gjithë aktorët relevant për këtë ligj. Sipas saj, ky ligj nuk ka nevojë shumë për sugjerime dhe ndryshime, mirëpo që prapëseprapë ka nevojë për prezencën e përfaqësuesve të MASHT-it për të vazhduar ashtu siç duhet. Nga ky dëgjim publik ajo tha se duhet të dalë me rekomandime që ndihmojnë në procesin e miratimit të këtij ligji.

Fidan Rekalii u pajtua me qëndrimet paraprake të deputetëve dhe tha se ky ligj është një rëndësie të veçantë duke marrë parasysh faktin që për herë të parë po shqyrtohet këtu. Ai gjithashtu theksoi nevojën për mbajtjen e një dëgjimi publik, ku të ftuar të jenë palët e interesit në kuadër të këtij ligji që do të japin kontributin dhe idetë e tyre për organizimin e këtij ligji i cili prek edhe fushën e të rinjve.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi